



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1277/2 Prot.

Tiranë, më 26.09.2025

V E N D I M

Nr. 222, datë 26.09.2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, shqyrtoi ankesën 189, datë 03.09.2025 të znj. A. Z., kundër Shoqatës së Transportit Urban të qytetit, në Bashkinë e Korçës, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *Quhem A. Z.. Prej vitit 2023 jam shoqëruese e babait tim, i cili gëzon statusin e të verbrit. Ai është pajisur me librezë invaliditeti, e cila jep të drejtën për të marrë shërbimin falas, si për të, ashtu edhe për mua si shoqëruese.*

Po ju drejtohem ju si institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi prej shumë kohe si unë, ashtu edhe shumë shoqërues të tjerë, po hasim vështirësi në transportin urban qytetas, ku faturinot na detyrojnë të paguajmë biletë kur hipim në to, edhe pse neni 11 i Ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar, e ka të parashikuar qartë që: të verbërit kanë të drejtë që ata dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban qytetas dhe me gjysmë çmimi në transportin ndërrurban, duke përfshirë si atë shtetëror edhe atë privat. Jam drejtuar shpeshherë pranë institucioneve të ndryshme për të marrë përgjigje për zgjidhjen e këtij problemi, por deri më sot nuk është bërë asgjë konkrete. Kam kontaktuar edhe pronarin e linjës së urbanit të qytetit të Korçës dhe përgjigja e tij ka qenë që: “Nuk është në dorën tonë, por e ka

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Bashkia Korçë. Nëse Bashkia jep subvencionimin e kësaj pagese, siç ndodh edhe për pensionistët, ne jemi të gatshëm ta zbatojmë."

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi hetimin e rastit për konstatimin e diskriminimit, si dhe heqjen e pagesës së urbanit të qytetit për shoqëruesit.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, përcaktohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *"Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".*

Neni 7/1 i LMD-së³, parashikon se: *"Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim".*

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁴, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010

³ Shkurtesë për Ligjin *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar.

⁴ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: *"Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi..."*

“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në vijim të ankesës, është administruar pranë Komisionerit, nëpërmjet email-it të datës 12.09.2025 i përfaqësueses të Zyrës Rajonale Korçë, një deklaratë nga znj. A. Z. Në këtë deklaratë, ajo informon Komisionerin se tërhiqet nga ankesa nr. 189 Regj., datë 03.09.2025, ku sqaron se: *Pas dorëzimit të ankesës tek ju, kam kontaktuar me specialistin për transportin publik pranë Bashkisë Korçë, i cili është përgjegjës për çështjet që lidhen me organizimin dhe funksionimin e transportit urban qytetas. Gjatë bisedës me të, e kam informuar në mënyrë të detajuar mbi situatën e paraqitur në ankesë, duke theksuar vështirësitë e hasura nga shoqëruesit e personave të verbër gjatë përdorimit të transportit publik, si dhe bazën ligjore që garanton të drejtën për përfitim nga ky shërbim. Në mënyrë të veçantë, e kam vënë në dijeni se në Librezën e Invaliditetit, konkretisht në nenin 11, është e përcaktuar qartë se të drejtën për përfitimin e shërbimit e gëzojnë si personi me status të verbëri, ashtu edhe shoqëruesi i tij. Pas konsultimit që specialisti i Bashkisë pati me përfaqësuesin e operatorit të transportit urban në qytetin e Korçës, u ra dakord që shoqëruesit e personave të verbër nuk do të detyrohen të paguajnë biletë për transportin urban. Gjithashtu, u theksua se shoqëruesit duhet të kenë me vete, në çdo moment, një dokument identifikues personal, për të vërtetuar lidhjen me përfituesin dhe për të garantuar zbatimin korrekt të përjashtimit nga pagesa. Me këtë deklaratë konfirmoj përpjekjet e mia për zgjidhjen e kësaj çështjeje dhe vendimin e marrë nga autoritetet përkatëse në nivel vendor dhe nga operatori i transportit.*

Me e-mailin e datës 17.09.2025, është përcjellë nga përfaqësuesja e Zyrës Rajonale Korçë kërkesa për tërheqje nga ankuesja, e cila me këtë kërkesë i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi, si më poshtë vijon: *“Unë, e quajtura A. Z., banuese në Bashkinë e Korçës, kërkoj nga ana juaj pushimin e ankesës së paraqitur para jush, pasi çështja ime është zgjidhur nga institucioni i Bashkisë dhe me ndihmën e dhënë, përmes ndërhyrjes së specialistes së Zyrës së KMD Korçë.”*

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,* të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,* të ndryshuar, parashikohet se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94⁵/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, znj. A. Z., kundër, Shoqatës së Transportit Urban të qytetit, në Bashkinë e Korçë, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Subjekti ankues ka deklaruar, me anë të e-mailit të datës 12.09.2024, se është tërhequr nga ankesa e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesja në datën 26.05.2025, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 189 regj., datë 03.09.2025, të paraqitur nga ankuesja znj. A. Z., nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik⁶.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 189 Regj., datë 03.09.2025, të znj. A. Z., për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁵ “Tërheqja e ankesës”.

⁶ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 230, datë 07.11.2023, Vendimin nr. 104, datë 22.04.2024, të KMD-së.